



## KONTRATË

Numri i kontratës<sup>1</sup>: 632-23-13856-2-2-5/C865

**KOMUNA E GJAKOVËS** (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

**CAPITAL X FET SH.P.K.**, Martirët Dushi 11, Klinë, 811367920, me nr.unik. 811367920 e përfaqësuar nga **Egzon Bytyqi** (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

**Mirëmbajtja e objekteve-pastrimi i objekteve të KPSH-së dhe QPS-së** me numër identifikues: 632-23-13856-2-2-5 dhe numër të brendshëm 632-23-190-225

### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve:

**Mirëmbajtja e objekteve-pastrimi i objekteve të KPSH-së dhe QPS-së**

| No. | Lot                                                                |
|-----|--------------------------------------------------------------------|
| 1   | Mirëmbajtja e objekteve-pastrimi i objekteve të KPSH-së dhe QPS-së |

### Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: **84,210.30 €** (tetëdhjetë e katërmijë e dyqind e dhjetë euro e tridhjetë cent).

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

### Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Marrëveshja e kontratës;
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

<sup>1</sup> Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

**Neni 4****Komunikimet**


4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

**Për Autoritetin Kontraktues**

|                    |                                                                                    |
|--------------------|------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Emri:</b>       | Faton Gutaj                                                                        |
| <b>Pozita:</b>     | Zyrtar përgjegjës i prokurimit                                                     |
| <b>Nënshkrimi:</b> |   |
| <b>Data:</b>       | 18.12.2023                                                                         |
| <b>Vula:</b>       |  |

**Për Ofruesin e Shërbimeve**

|                    |                                                                                     |
|--------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Emri:</b>       | Egzon Bytyqi                                                                        |
| <b>Pozita:</b>     | Drejtor                                                                             |
| <b>Nënshkrimi:</b> |  |
| <b>Data:</b>       | 18.12.2023                                                                          |
| <b>Vula:</b>       |  |

# KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 632-23-13856-2-2-5/C865

## Neni 1 Përkufizimet

1.1 **"Kontratë"** do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 **"Shërbimet"** do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 **"Ofruesi i shërbimeve"** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 **"Personeli"** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 **"Çmimi i kontratës"** do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 **"Nënkontraktuesi"** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 **"Palë"** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palët" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 **"Autoriteti Kontraktues"** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 **"KPK"** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **"KVK"** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

## Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

## Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
- b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

## Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura

Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktonte pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Nëse nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

## **Neni 5 Tatimet dhe Doganat**

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

## **Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve**

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose në një datë tjetër të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.

6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzoj Autoritetit Kontraktues për miratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.

6.3 Ofruesi i Shërbimeve do të filloj shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrat me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.4 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KVK. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

6.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

## **Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit**

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritët se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) forca madhore siç është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënua për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetojë Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

## **Neni 10 Ndërprerja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve**

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafte të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

## **Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve**

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrat. Ekzekutimi i urdhrat administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të jenë bashkërisht dhe vazhdimisht të obliguar t'i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi që të veprojë në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësoj personelin kyç të identifikuar në tender e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhe në bazë të kërkesës me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë për një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryen detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë janë thelbisht të barabarta ose më të mirë se ato të identikuara.

## **Neni 12 Obligimet e Autoritetit Kontraktues**

12.1 Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunoj sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kërkoj në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "*Menaxherin e Projektit*", i ceku në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

## **Neni 13 Dëmet e likuiduara**

13.1 Ofruesi i Shërbimeve do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofruesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse Data e përfundimit është zgjatur pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti kontraktues do të përmirësojë çdo pagesë të tepërt të dëmeve të likuiduara nga ofruesi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën e ardhshme të pagesës.

## **Neni 14 Siguria e ekzekutimit**

14.1 Ofruesi i Shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosëkzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Siguria do të vazhdoj të jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

## **Neni 15 Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve**

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

## **Neni 16 Parimet e përgjithshme të pagesës**

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i behet Ofruesit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate do të specifikohen në KVK.

16.2 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.3 Shumat duhet të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

#### **Neni 17                    Kontrolli i kualitetit**

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është si në KVK.

#### **Neni 18                    Korrigjimi i defekteve**

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

#### **Neni 19                    Konsekuencat e Shkeljes se kontratës**

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) Dëme të përgjithshme; ose
- b) Dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

#### **Neni 20                    Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

## **Neni 21                    Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

## **Neni 22                    Dëmshpërblimi**

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë së sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj palë të tretë.

# KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 632-23-13856-2-2-5/C865

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës               |           | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |
|---------------------------------------------------|-----------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Përshkrimi i nenit                                | Nr. Nenit |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha                      | 2.1       | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
|                                                   | 2.2       | Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
| Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve               | 6.1       | Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është 18.12.2023                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
|                                                   | 6.4       | Data e Përfundimit është 17.06.2024<br><b>Vërejtje:</b> Nëse aktiviteti i prokurimit për të cilin është zhvilluar procedurë e hapur, dhe lënda që gjendet në OSHP kryhet, atëherë kjo kontratë ndërpritet.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |
|                                                   | 6.5       | Vendi i kryerjes së shërbimeve është në Komunën e Gjakovës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| Obligimet e Autoritetit Kontraktues               | 12.3      | Menaxheri i Projektit do të caktohet me vendim të ZKA.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
| Dëmet e likuiduara                                | 13.1      | Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25% e Çmimit final të Kontratës në ditë.<br>Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| Siguria e ekzekutimit                             | 14.1      | Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës me vlefshmëri prej 7 muaj.<br>Kontraktuesi obligohet që para nënshkrimit të kontratës të bëjë depozitimin e sigurisë së ekzekutimit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve | 15.1      | Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë:<br>Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;<br>Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.<br>Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:<br>e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar<br>e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar |
| Parimet e përgjithshme të pagesës                 | 16.1      | Kërkesat për pagese do të bëhen për shërbimet e performuara në baza mujore (ex post).<br>Pagesa do të autorizohet dhe do të bëhet nga Autoriteti Kontraktues për shërbimet e performuara në baza mujore (ex post).<br><b>Nuk ka pagese paraprake.</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |

|                                                   |      |                                                                                                                                                                                                              |
|---------------------------------------------------|------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Kontrolli i kualitetit                            | 17.1 | Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë:<br><br>-Inspektimi i shërbimeve kryhet nga Menaxheri i projektit i caktuar nga Komuna.                      |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes               | 20.2 | Komisioni për ndërmjetim pranë Ministrisë së Drejtësisë                                                                                                                                                      |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedurë gjyqësore | 21.1 | a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë |

## ANEKSI 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

1. Përshkruaj në mënyrë jo diskriminuese, karakteristikat e detyrueshme të objektit të kontratës siç janë: Kualiteti, sigurimi i kualitetit, performanca, terminologjia, kërkesat e dizajnit, simbolet, dimensionet, testimi dhe metodat e testimit, sigurimi, paketimi, shënjimi, etiketimi.

Specifikimet teknike duhet të përpilohen në mënyrë që të përputhen me qëllimin e prokurimit dhe të ofrojnë qasje sa më të madhe të operatorët ekonomik të interesuar.

Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar të vendos specifikime teknike që favorizojnë ose dis-favorizojnë një ose me shumë operatorë ekonomik.

### 1. Kontratë gjashtë mujore (6) ose deri në lidhjen e kontratës së re

2. Me këtë kontratë parashihet angazhimi i punëtorëve (pastruesve) për mirëmbajtjen e higjienës në objektin e QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve në tërë territorin e Komunës së Gjakovës dhe Qendrës për Punë Sociale (gjithsej 27 objekte). Punëtorët e angazhuar me këtë kontratë do të punojnë 8 orë në ditë / 40 orë në javë në objektet e lartë cekura. Numri i punëtorëve që do të angazhohen me këtë kontratë do të jetë **24** punëtorë në pozitën pastrues, por që varësisht nga nevoja AK (QKMF-së) mund të bëjë heqjen apo shtimin e punëtorëve (pastruesve) ose **m2** të pastrimit

3. Shërbimi i pastrimit ofrohet ditëve të punës neper AMF, QMF dhe QPS, përjashtimisht për QKMF shërbimi ofrohet shtatë (7) ditë në javë duke përfshirë edhe vikendet dhe festat zyrtare (pa kosto shtesë për kërkuesin e shërbimit, orët shtesë kompensohen me zëvendësime ose ditë pushimi), sipas nevojave të AK edhe në QMF-te tjera mund të ofrohen shërbimi i pastrimit edhe ditëve të vikendit dhe festave, **pa kosto shtesë për Autoritetin Kontraktues (orët shtesë kompensohen me zëvendësime ose ditë pushimi);**

4. Paga bazë mujore (katërqind) 400 € bruto për punëtorë duke përfshirë edhe pagesën e kontributeve të pensioneve mujore, OE duhet të prezantojë një analizë financiare e cila do të arsyetojë çmimin e dhënë për kryerjen e obligimit të pagave, punës sipas ndërrimeve, pagesën e kontributeve, tatimeve, TVSH si dhe detyrimeve tjera ligjore dhe pagesën e pushimeve vjetore, mos dhënia e kësaj analize nga OE atëherë AK do të eliminojë si të pa përgjegjshëm ofertën e operatorit ekonomik, duke përfshirë edhe pagesën taksave (tatimeve) dhe kontributeve pensionale në paga të parapara me ligje në fuqi;

5. Operatori ekonomik me rastin e prezantimit të faturës për pagesë, duhet që të sjellë edhe pagesat e kontributeve të pensioneve për secilin punëtorë të angazhuar, duke i sjellë dëshmitë nga ATK-ja deri me datë 15 të muajit pasues, (përjashtim nga ky rregull do të ketë vetëm për muajin e parë pas nënshkrimit të Kontratës);

6. Që në baza të rregullta mujore me se largu deri me date 05 te muajit, të bëjë furnizimin me material higjienik sipas specifikacioneve dhe sasisë të precizuar ( gjeni të bashkangjitur);

7. Sasia e mallit të sjellë të jetë evidentuar nga depoisti përgjegjës në kuadër të QKMF-së, dhe i/e cila raporton për sasinë e mallit të sjellë nga OE;

8. Tualetet dhe ordinancat e mjekeve dhe zyrat tjera ne kuadër te objekteve të jenë gjithnjë të pastruara dhe furnizuara me letër higjienike (duar dhe tualet) dhe sapun i lëngët për duar ( te pastrohen se paku 2 here brenda orarit të punës 8 ore dhe sipas nevojë edhe më shume). Çdo tualet duhet të ketë listën e mirëmbajtjes së pastrimit dhe të dorëzoj raport mujorë;

9. Gjithashtu OE duhet që në bazë të specifikave të poshtë shënuara të siguroj vetëm këto lloje të materialeve higjienike:

- Detergjent për dyshemel;
- Dezinfektuese për banjo - (zbardhues ) 1L
- Pastrues për lavaman dhe guaskë të tualetit: i kualitetit të lartë 1l;
- Detergjent i lëngshëm 500 ml
- Sapun i lëngshëm për duar /1L
- Lëng për pastrimin e ramave te dritareve - 1L
- Qese te zeza për mbeturina 120 L (komplet 1/10)
- Qese për mbeturina 60 L (komplet 1/10)
- Letër e palosur për duar (komplet 1/100)
- Letër Tualeti ne formatin rrollne dy shtresore për aparat (Komplet 1/10)
- Trolex (komplet 1/3)
- Kove për secilin punëtor (zëvendësohen me te reja çdo 3 muaj)
- Xhoker me bisht
- Lëkur për xhama
- Fshesa Elektrike thithës vakum (ne fillim te kontratës 2 copa, paguhen me këtë çdo muaj) fuqia 2500 Wat.
- Fshesa me bisht me lopata plastike
- Fshesa për Merimanga
- Sprej për xhama / 750 ml
- Brusha për guace të WC çdo muaj.

Furnizimi me material të lartcekur nga OE behet 1 here në muaj.

10. OE ekonomik, në javën e parë pas nënshkrimit të kontratës duhet që për secilën banjë në secilin objekt administrativë të sjell nga një aparat automatik për vendosjen e letrës higjienike dhe sapunëve të lëngshëm si dhe nga një tharëse të duarve;

10. OE ekonomik, në javën e parë pas nënshkrimit të kontratës duhet që për secilën pastrueses të sigurojë nga një mjet transporti ku do i vendosin të gjitha materialet higjienike për pastrim dhe nga një shenjë informuese për kujdesin në lëvizje pas pastrimit të dyshemesë ;

11. Dritaret të pastrohen së paku njëherë në javë, dyshemetë e korridoreve, sallat, zyrat administrative dhe ordinancat të pastrohen së paku njëherë gjatë orarit 8 orësh, nëse zyre apo ordinanca punon më gjatë se 8 ore gjatë dite ajo duhet të pastrohet së paku 2 here dhe sipas nevojë edhe më shume, oborret dhe hapësirat jashtë objekteve të pastrohen së paku dy (2) here në javë;

12. Faturimi të jetë detal dhe duhet të përcillet me raport mujor për gjendjen e mirëmbajtjes dhe të prezantohet procesi;

13. Shpenzimet e mirëmbajtjes( detergjentet dhe mjetet për pastrim sipas specifikacionit) i bartë firma fituese;

14. Uniformat për punëtorët (dy palë sipas sezonës verë dimër ) duhen që të sigurohen nga OE sipas nevojës dhe përshtatshmërisë së punëtorëve gjatë muajit të parë pas nënshkrimit të kontratës;

15. Pastrimi të jetë i bazuar në metër katrore, kompania duhet të caktoj një menaxher për mbikëqyrjen e punës dhe koordinim me Autoritetin Kontraktues , i cili do duhet të llogaritet në Analizën Financiare siç parashihet në piken 4 të Specifikimeve Teknike ;

16. Pastrimi të bëhet brenda orarit të punës dhe secila pastruese të nënshkruhet në çdo kohë kur përfundon pastrimin(varësisht sa caktohet koha sipas planit dinamik);

17. Punëtorët duhet të paguhën më së largu deri me datë 05 të muajit në vijim, të respektohen konform kodit të etikës dhe rregullave mbi të drejtën e punëtorit në punë, dhe të bëhet urdhër-transferi i pagës ndërmjet bankës, në të kundërtën pas 2 (dy) vërejtjeve me shkrim në raport me këtë çështje do shkaktojnë shkëputje dhe prishje të njëanshme të kontratës;

18. Furnizimi me material higjienik të sjellët gjithnjë sipas llojit dhe sasisë së specifikuar, dhe me afat dhe cilësi adekuate, në të kundërtën mungesa e furnizimit adekuat sipas specifikacionit nuk do të pranohet dhe pas 2 (dy) vërejtjeve me shkrim në raport me këtë çështje do shkaktojnë shkëputje dhe prishje të njëanshme të kontratës;

19. Të prezantohet plani dinamik i punës sipas objekteve të paraqitura në kërkesën me AK dhe furnizimeve me material sipas tabelarit të prezantuar nga AK si dhe afati i liferimit nuk

duhet te jete me larg se data 05 i muajit, punëtorët e cekur me larte nuk mund te angazhohen nga OE në pune jashtë objektiv te KPSH (QKMF,QMF, AMF dhe QPS);

|    | Furnizimi dhe mirembajtjen higjenike për një muaj                        |            |        |
|----|--------------------------------------------------------------------------|------------|--------|
|    | Hapesirat                                                                | Nj. matese | Sasia  |
| 1  | Detergjent për DysHEME / 1 L                                             | liter      | 120.00 |
| 2  | Dezinfektuese për banjo - (zbardhues ) 1L                                | liter      | 70.00  |
| 3  | Pastrues për lavaman dhe guace - (thartire acid chlorhydric HCL) 1 L     | liter      | 27.00  |
| 4  | Detergjent i lengshem 500 ml                                             | mliter     | 27.00  |
| 5  | Sapun i lëngshëm për duar /1L                                            | cope       | 200.00 |
| 6  | Leng per pastrimin e ramave te dritareve - 1L                            | liter      | 27.00  |
| 7  | Qese te zeza për mbeturina 120 L (komplet 1/10)                          | komplet    | 82.00  |
| 8  | Qese për mbeturina 60 L (komplet 1/10)                                   | komplet    | 82.00  |
| 9  | Letër e palosur per duar (komplet 1/100)                                 | cope       | 900.00 |
| 10 | Letër Tualeti ne formatin rrollne dy shtresore per aparat (Komplet 1/10) | komplet    | 90.00  |
| 11 | Troxex (komplet 1/3)                                                     | cope       | 53.00  |
| 12 | Kove për secilin punëtor (zëvendësohen me te reja çdo 3 muaj)            | cope       | 27.00  |
| 13 | Xhoker me bisht                                                          | cope       | 50.00  |
| 14 | Lëkur për xhama                                                          | cope       | 27.00  |
| 15 | Fshesa Elektrike ( produkti dorzohet ne fillim të kontrates )            | cope       | 2.00   |
| 16 | Fshesa me bisht me lopata plastike                                       | cope       | 27.00  |
| 17 | Fshesa për Merimanga (zëvendësohen me te reja çdo 3 muaj)                | cope       | 20.00  |
| 18 | Sprej për xhama / 750 ml                                                 | cope       | 27.00  |

|    |                           |      |       |
|----|---------------------------|------|-------|
| 19 | Brusha për guace qdo muaj | cope | 30.00 |
|----|---------------------------|------|-------|

| Nr | Qendrat                              | Punëtorët | Orari                  |
|----|--------------------------------------|-----------|------------------------|
| 1  | QKMF                                 |           | Orari i plote          |
|    |                                      |           | Orari i plote (8 orë)  |
|    |                                      | 6 puntorë | Orari i plote (8 orë)  |
|    |                                      |           | Orari i plote (8 orë)  |
|    |                                      |           | Orari i plote (8 orë)  |
|    |                                      |           | Orari i plote (8 orë)  |
| 2  | QMF-1                                | 1 puntorë | Orari i plote (8 orë)  |
|    |                                      |           | Orari i plote (8 orë)  |
|    |                                      | 1 puntorë | Orari i plote (8 orë)  |
|    |                                      | 1 puntorë | Orari i plote (8 orë)  |
| 3  | QMF Çabrat                           | 1 puntorë | 2 Ditë të javës        |
| 4  | QMF Skivjan                          |           | 3 Dite te javes        |
| 5  | AMF- Novosell                        | 1 puntorë | Orari i plote (8 orë)  |
| 7  | QMF Brekoc                           | 1 puntorë | 3 Dite te javes        |
| 8  | AMF Dol                              |           | 2 Dite te javes        |
| 9  | QMF Orize                            | 1 puntorë | 8 orë në dite          |
| 10 | QMF Orize                            | 1 puntorë | Orari i plote (8 orë)  |
| 11 | QMF Ereniku dhe Njesia e Mamografisë | 1 puntorë | Orari i plote (8 ore ) |
| 12 | QMF Ponoshec                         | 1 puntorë | 1 Dite te javes        |
| 13 | AMF Babaj Bokes                      |           | 1 Dite te javes        |
| 14 | AMF Molliq                           |           | 3 Dite te javes        |
| 15 | AMF Sheremet                         | 1 puntorë | 3 Dite te javes        |
| 16 | AMF Korenica                         |           | 1 Dite te javes        |
| 17 | AMF Guskë                            |           | 1 Dite te javes        |
| 18 | QMF Cermjan                          |           | 1 Dite te javes        |
| 19 | AMF Gergoc                           | 1 puntorë | 1 Dite te javes        |
| 20 | AMF Krelan                           |           | 2 Dite te javes        |
| 21 | AMF Shqiponje                        |           | 1 Dite te javes        |
| 22 | AMF Doblibare                        | 1 puntorë | 2 Dite te javes        |

|    |               |           |                       |
|----|---------------|-----------|-----------------------|
| 23 | AMF Bec       |           | 3 Dite te javes       |
| 24 | QMF Rogove    | 1 puntorë | Orari i plote (8 orë) |
| 25 | AMF Damjan    | 1 puntorë | Orari i plote (8 orë) |
| 26 | AMF Bistazhin | 1 puntorë | 3 Dite te javes       |
| 27 | AMF Lipovec   |           | 2 Dite te javes       |
| 28 | QMF Dardani   | 1 puntorë | Orari i plote (8 orë) |
| 29 | QPS           | 1 puntorë | Orari i plote (8 orë) |

**Mirëmbajtja dhe pastrimi objekteve te KPSH-së dhe QPS-së**

| Nr.                     | Përshkrimi                                               | Njësia<br>Matëse | Sasia   | Çmimi<br>njësi me<br>TVSH | Muaj | Çmimi<br>total me<br>TVSH |
|-------------------------|----------------------------------------------------------|------------------|---------|---------------------------|------|---------------------------|
| 1                       | Sipërfaqet e detajuara në objektet e Komunës së Gjakovës | m <sup>2</sup>   | 6747.62 | 2.08                      | 6    | 84,210.30                 |
| Gjithsej totali me TVSH |                                                          |                  |         |                           |      | 84,210.30                 |

*[Signature]*

SH.P.K  
CAPITAL X  
FET  
811357920  
KLINE



# ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

## Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E EKZEKUTIMIT

Pjesë përbërëse e Policies me Nr. **121038**

Për **KOMUNA E GJAKOVES**

( Emri i "Autoritetit Kontraktues" )

Në emër të **Capital X Fet SH.P.K.**

(emri dhe adresa e "Operatori Ekonomik" dhe nr. i biznesit në vazhdim Operatori Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **MIREMBAJTJE E OBJEKTEVE-PASTRIMI I OBJEKTEVE TE KPSH- DHE QPS-SE**  
Nr. prokurimit: 632 23 13856-225 , Nr. brendshëm: 632 23 190 225

### Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartëcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartëcekur të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **8,421.03€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe;
- Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej **8,421.03€** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 213 ditë kalendarike prej **18.12.2023** deri më **18.07.2024**

Data lëshimit: 18.12.2023

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit



Ky garancion i nënshtrohet rregullave uniforme për garancione (UPDG), botim 2010, Publikimi ICC Nr. 758.



# ELSIG

Gjithcka që duhet ta keni



Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.  
Kompania e sigurimeve ELSIG sh.a, Prishtinë, Adresa: Rr. "Tringë Ismajli"-nr.19,  
Tel: +383 (0) 38 221 112; Fax: +383 (0) 38 221 115, E-mail: office@kselsig.com

## POLICË PËR SIGURIMIN E GARANCISË SË EKZEKUTIMIT TË KONTRATËS

Nr. Polices: **121038**

### Kontraktuesi

|                 |                           |
|-----------------|---------------------------|
| Emri            | Capital X Fet SH.P.K.     |
| Përfaqësuar nga | EGZON BYTYQI              |
| Adresa          | Klinë, Martiret Dushi, 11 |
| Nr i Biznesit   | 811367920                 |
| Telefoni        | 044616992                 |

### Përfituesi

|        |                   |
|--------|-------------------|
| Emri   | KOMUNA E GJAKOVES |
| Adresa | GJAKOVE           |

### Garantuesi

|             |       |
|-------------|-------|
| Emri        | Elsig |
| Banka       | NLB   |
| Garantuesit |       |

### Mbulueshmëria e Polices

|                    |                         |
|--------------------|-------------------------|
| Shuma Siguruar     | 8,421.03                |
| Periudha Sigurimit | 18.12.2023 - 18.07.2024 |
| Primi              | 151.58                  |
| Tvsh               | 27.28                   |
| Primi Bruto        | 178.86                  |
| Data e lëshimit    | 18.12.2023 12:21        |

### Aktiviteti Ekonomik:

MIREMBAJTJE E OBJEKTEVE-PASTRIMI I OBJEKTEVE TE KPSH-DHE QPS-SE

### Lënda e Garancisë

Detyrimet e Siguruesit ndaj Përfituesit sipas kësaj Police të sigurimit janë:

1. Mbështetur në këtë Police - Garancie, Siguruesi / Garantuesi merre përsipër që të plotësojë çdo detyrim kontraktori i cili është i garantuar me këtë police.
2. Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit / Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet kontraktuale nuk plotësohen për faj të të Siguruarit / Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.
3. Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit, Siguruesit/Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet të Siguruarit/Kontraktuesit, me të gjitha mjetet ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi të Siguruesit/Garantuesit).
4. Ky sigurim është lidhur sipas Kushteve të përgjithshme të Sigurimit të Garancive dhe ekzekutimit të kontratës të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj Police.
5. Për polica të sigurimit - Ekzekutimi i kontratave - pjesë përbërëse e kësaj police është kontrata e ekzekutimit të punëve ndërmjet autoritetit kontraktues (Përfituesi) dhe Operatori Ekzekutues (të Siguruarit) di dhe marrëveshja e lidhur në mes Siguruesit dhe Operatorit Ekonomik (hipoteka e lënë peng)

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pajtohem që Kompania e Sigurimit ti ruaj të dhënat e mia personale / të dhënat e biznesit, të cilat do të përdoren nga Kompania për qëllime statistikore, hulumtim/raportim në Regjistrin Kreditor të Kosovës si dhe transferim tek një palë e tretë me qëllim të trajtimit të dëmeve.

Me nënshkrimin e kësaj police të sigurimit, nënkuptohet se unë i siguruari me vullnet të lirë, të barabartë dhe me mirëbesim kam pranuar primin e sigurimit, kam lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet e sigurimit.  
My signature in this insurance policy signifies that I the insured with good will have accepted the insurance premium. I have read, understood and accepted the insurance terms and conditions



Kompania e Sigurimeve Elsig  
Rilind Magjaraj - 1210



Përfaqësuesi i të siguruarit  
EGZON BYTYQI